

1- Cilin veprim nuk mund të kryejë oficeri i policisë gjyqësore në rastet kur një person, që nuk është marrë si i pandehur, bën deklarime, nga të cilat dalin të dhëna për inkriminim në ngarkim të tij

- a) Ndërpret pyetjen
- b) E paralajmëron se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij
- c) E fton të caktojë një mbrojtës.
- d) **E njofton se deklaratimet e mëparshme mund të perdoren ndaj tij gjatë hetimit dhe gjyqimit**

2- Cili pohim është i pasaktë:

Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:

- a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç;
- b) nuk dëgjon dhe nuk flet;
- c) **është me aftësi të kufizuara**
- d) është deklaruar i ikur ose në mungesë, me vendim gjyqësor;
- e) merret në pyetje personi i arrestuar ose i ndaluar

3- Cili është pohimi i saktë :

Nuk ka përgjegjësi penale personi që:

- a) e kryen veprën penale nga nevoja për të përballuar një rrezik real dhe të çastit që e kërcënon atë, me kusht që dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbropsur
- b) **që vepron për të ushtruar të drejta apo përmbushur detyra të caktuara nga ligji**
- c) vuan nga një turbullim psikik apo neuropsikik

4- Cili është pohimi tërësisht apo pjesërisht i pasaktë:

Nuk ka përgjegjësi penale personi që:

- a) **e kryen veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë dhe i çastit**
- b) vepron për të ushtruar të drejta apo përmbushur detyra të caktuara nga një urdhër i dhënë prej një personi kompetent, veç rastit kur urdhri është haptazi i paligjshëm

- c) personi që me vullnetin e tij dhe në mënyrë përfundimtare heq dorë nga kryerja e veprës penale, megjithë mundësitë për kryerjen e saj

5- Cilat është pohimi i saktë :

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë zbatohet ndaj shtetasit të huaj që ndodhet në Shqipëri dhe nuk është ekstraduar, kur ka kryer jashtë territorit të Shqipërisë një nga veprat e mëposhtme:

- a) **Torturë**
- b) Shpërndarjen kompjuterike të materialeve pro genocidit ose krimeve kundër njerëzimit
- c) Veprat e dhunshme ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht
- d) Pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj

6- Është i saktë pohimi :

Marrja në pyetje e personit ndaj të cilit policia gjyqësore ka zbatuar një masë shtrënguese ose ndaluese, përveç arrestit në burg, (procesverbalin për zbatimin e të cilës policia gjyqësore duhet t'ja dërgojë gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit), duhet të bëhet nga gjykata brenda:

- a) Dy ditësh
- b) Tre ditësh
- c) Katër ditësh
- d) **Pese ditësh**

7- Cili është pohimi i saktë:

Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës penale kanë kaluar:

- a) 35 vjet për krime që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm
- b) 25 vjet për krime që parashikojnë dënim jo më të ulët se 10 vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë
- c) 5 vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në 2 vjet burgim
- d) **2 vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë**

8- Cili është pohimi i pasaktë:

Nuk është vrasje në rrethana të tjera cilësuese vrasja e kryer:

- a) Në mënyrë të tillë që I shkakton mundime të veçanta viktimës
- b) Në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave
- c) **Që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër**
- d) Ndaj palëve të tjera ndërgjyqëse

9- **Është vepër penale me dy objekte:**

- a) Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit
- b) Vjedhja e veprave të artit dhe kulturës
- c) **Vjedhja me pasojë vdekjen**
- d) Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive elektronike

10- **Cilë është pohimi i pasaktë:**

- a) **Organizata terroriste është formë e veçantë e organizatës kriminale e përbërë nga tre ose më shumë persona, që kanë bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste**
- b) Grupi i strukturuar kriminal nuk formohet rastësisht e nuk është e dallueshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme
- c) Anëtarët e organizatës kriminale janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre, në përmbushje të qëllimeve të veprimtarisë kriminale,
- d) Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona në marrëveshje ndërmjet tyre

11- **Cili është pohimi i pasaktë ose jo plotësisht i saktë.**

Nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

- a) **gjinia ose krushqia afërt e të pandehurit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, edhe në rastet kur mund të kenë bërë kallëzim apo ankim**
- b) bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore;
- c) ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të;
- d) ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësimi.

12- **Gjeni pohimin e pasaktë:**

Nga ana objektivë trafikimi i narkotikëve kryhet përmes:

- a) Eksportimit
- b) Importimit
- c) **Transportimit**
- d) Tregtimit

13- Gjenerali pohimin e saktë

Marrja në pyetje e të arrestuarit ose ndaluarit në prani të mbrojtësit bëhet nga:

- a) Oficeri i policisë gjyqësore
- b) Oficeri i policisë gjyqësore me autorizim të prokurorit
- c) **Prokurori**
- d) Nga oficeri i policisë gjyqësore ose prokurori

14- Gjenerali pohimin e saktë.

Kur oficeri i policisë gjyqësore sekuestron sende në vendngjarje, ia dërgon procesverbalin për vleftësim prokurorit brenda:

- a) 24 orëve
- b) **48 orëve**
- c) 72 orëve
- d) 12 orëve

15- Gjenerali pohimet e pasakta ose jo plotësisht të sakta.

Heqja dorë nga e drejta e ankimit në rastet kur ndjekja penale fillon vetëm me ankimin e viktimës bëhet:

- a) Para prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore
- b) **Vetëm me deklaratë të shkruar**
- c) Me deklaratë të shkruar ose me gojë
- d) Personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të viktimës

16) Gjени pohimin e pasaktë.

Kur masa e arrestit ose e ndalimit ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vleftësimin e masës:

- a) Prokurori urdhëron me vendim të motivuar lirimin e menjëhershëm
- b) Lirimi i menjëhershëm urdhërohet edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili njofton menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi
- c) **Brenda 24 orëve nga kalimi i afatit, gjykata me kërkesë të prokurorit urdhëron lirimin e menjëhershëm të të ndaluarit ose arrestuarit**

17. Gjени pohimin e pasaktë ose jo plotësisht të saktë.

Plagosja e rëndë me dashje kryhet në rrethana cilësuese kur:

- a) Është kryer kundër disa personave
- b) Kundër bashkëshortit
- c) Kundër bashkëjetuesit
- d) **Ka shkaktuar dëmtim të përhershëm të shëndetit**

18. Gjени pohimin e pasaktë.

Marrja e kampionëve biologjikë dhe çdo lloj procedure mjekësore kryhet pa pëlqimin e personit, edhe kur nuk ka arsye për të besuar se nga vonesa shkaktohet humbja ose dëmtimi vërtetësisë së provës, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) **Urdhërohet nga prokurori**
- b) Nuk dëmtohet shëndeti i personit;
- c) Ndërhyrja e domosdoshme për vërtetimin e fakteve;
- d) Fakti nuk mund të provohet me ndonjë mënyrë tjetër

19. Në lidhje me konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale, të parashikuar nga neni 36 i Kodit Penal, nuk është i vërtetë pohimi:

- a) Konfiskimi sipas këtij neni zbatohet ndaj sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë veprë penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi;
- b) Konfiskimi sipas këtij neni zbatohet ndaj produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;

- c) **Konfiskimi sipas këtij neni nuk zbatohen ndaj pasurive të tjera, të krijuara me të ardhura të ligjshme;**
- d) Konfiskimi sipas këtij neni zbatohen ndaj sendeve që janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;
- e) Konfiskimi sipas këtij neni zbatohet ndaj shpërblimeve të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

20 Në lidhje me veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nuk është i vërtetë pohimi:

- a. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;
- b. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen kur vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;**
- c. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;
- d. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën penale, nga e cila kanë rrjedhur produktet.

21. Është I pasaktë pohimi:

Cdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin:

- a) Bëhet gjithmonë në praninë e mbrojtësit dhe psikologut**
- b) Bëhet përjashtim nga rregulli i mësipërm vetëm kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike
- c) Bëhet përjashtim nga rregulli i mësipërm dhe/ose në rastet e parashikuara lidhur me gjëndjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës penale.

22. Nuk është dënim plotësues që jepet ndaj të miturit:

- a. **Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative;**
- b. Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;

- c. Kryerja e një pune në interes publik;
- d. Përbushja e detyrimeve të caktuara;
- e. Qëndrimi në shtëpi.

23. Nuk është i saktë pohimi:

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethanë lehtësuese kryhet kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) kur personi i rrëmbyer ose mbajtur peng lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi ose mbajtja peng
- b) pa e arritur qëllimin e krimit
- c) kur ndaj personit nuk është ushtruar torturë
- d) **kur nuk janë shkaktuar dëmtime të përhershme të shëndetit**

24. Nuk është i vërtetë pohimi:

Figura e veprës penale të shkaktimit të vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje të një personi konsumohet kur:

- a) **është rrjedhojë e trajtimit të keq të viktimës**
- b) ose vjen nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin e viktimës
- c) veprimet kryhen nga personi që e ka në varësi viktimën
- d) ose nga personi që ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese me viktimën

25. Nuk është i vërtetë pohimi

Heqja e paligjshme e lirisë kryhet në rrethana cilësuese kur:

- a) shoqërohet me vuajtje të rënda fizike
- b) ose kryhet në bashkëpunim
- c) ose kryhet kundër disa personave
- d) ose kryhet më shumë se një herë
- e) **ose kryhet duke përdorur apo duke kërcënuar me përdorimin e armës.**